

DIJA APRIRORIKE SI PROBLEM FILOZOFIK

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I FILOZOFISË

NGA

OSMAN GASHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I FILOZOFISË
PRISHTINË
SHTATOR, 2021

MENTORI:

Kristë SHTUFI, Ass. Dr., Mentor

KANDIDATI:

Osman Gashi

Dija apriorike si problem filozofik, është një temë mjaft aktuale dhe në aspektin teorik fare pak e trajtuar në literaturën e gjuhës shqipe. Prandaj nga rëndësia që ka kjo temë e meriton për t'u trajtuar. Në literaturën epistemologjike për dijen apriori i hasim tre koncepte: metafizik, epistemologjik dhe linguistik.

Koncepti metafizik është ne mese te të domosdoshmes dhe kontingjentes, p.sh., një propozicion është i vërtetë nëse është i mundshëm në të gjitha botëve, dhe kontingjent është i vërtetë të paktën një botë të mundshme.

Dallimi tjetër është dallimi epistemologjik kryesisht ne mes të koncepteve të apriorit dhe aposteriorit, një propozicion është apriori nëse është i njohur pavarësisht nga përvoja, p.sh. *“të gjithë beqaret janë të pamartuar”*.

Ndërsa një propozicion është aposterior nëse buron nga provoja, p.sh. *“të gjithë beqarët janë të pasur”*.

Dhe dallimi i tretë është linguistik, kryesisht në mes të gjykimeve analitike dhe sintetike, këtë dallimi më së miri e bënë Kanti një gjykim është analitik kur predikati është i përfshirë në subjekt; si p.sh. *“të gjithë njerëzit e gjatë janë të gjatë”*. Ndërsa gjykimet sintetike janë ato gjykime kur predikati nuk është i përfshirë në subjekt si p.sh. *“të gjitha grat janë të bukura”*.

Në kapitullin e I është trajtuar koncepti i apriorit dhe aposteriorit, dija apriori , justifikimi apriori, dy pikëpamjet kryesore të justifikimit apriori.

Kapitulli i II e shtjellon konceptin e analitikitetit dhe qasja analitike e dijes apriori nocioni i të vërtetave analitike ka luajtur një rol të rëndësishëm sidomos me Kantin, Fregen, Ayerin.

Filozofet të vërtetat analitike i kanë marr si të vërteta me një siguri absolute. Qëllimi i këtij kapitulli është zhvillimi i nocionit të analitikes te disa filozof si te Kanti, Ayeri, Frege etj.

Kapitulli i III-të për gjykimet analitike dhe sintetike dallime ne mes tyre si dallime semantike që ka të bëjë se çka e bënë një gjykim si të vërtet dhe jo të vërtet

Si dhe gjykimi sintetik apriori si një nga gjykimet më kontroverse kemi filozof pro dhe kundër ekzistimit të gjykimeve të tilla. Për Kantin detyra e filozofisë së tij teorike është të shpjegojë mundësinë e dijes sintetike apriori. Po ashtu në këtë kapitull do të elaborohet edhe koncepti i domosdoshmërisë dhe kontingjentes

Kapitulli i IV merret me teorinë linguistike të apriorit të Ayerit, propozicionet rreth rregullave gjuhësore, kufizimi i dijes nga rregullat linguistike.

Ayeri si një fenomenalist beson se objektet materiale janë konstruksione logjike, kontributi kryesor i Ayerit në epistemologji është në librin e tij *“The Problem of Knowledge”* të cilin vetë Ayeri e konsideron si më të avancuar në çështjet epistemologjike se sa vepra tjetër *“Language truth and logic”*.